

BAS AM
Nr. 6346...Fin.....
Dats 12.8.2020 M. Shkrimi
REPO
GJYKAT



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORCE**

Nr. 51 UM

Korçë, me 04.09.2020

SHPALLJE VENDIMI

Në këndin e afishimit të shpalljes pranë Njësisë Administrative Pirg, Bashkia Maliq.

Për shtetasin: **Aldi Agim Llapa.**

Me adresë: Fshati Pirg, Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dërgojme shpalljen për vendimin nr. **556, dt. 10.07.2020** për t'u afishuar nga ana e juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit është kthyer me shënimin personi ndodhet ne Itali dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Lubiana KINOLLI

U afishuar sot ne dt _____
Nënpunësi _____
(emër, mbiemër, firmë)

- Mj. Ad. Piring
- Dj. Tel. Tjg. Pakbet
10.09.2020

Pr. 114 P15t

Dt. 10.09.2020



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË**

Nr.21009-00433-41-2020 (51 UM).
Data e regjistrimit 04.05.2020

Nr.Vendimi 41-2020-877 (556)
Dt. Vendimi 10.07.2020

**VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e përbërë nga

GJYQTAR - ERVIN SULAJ

Asistuar nga sekretare seance **Adela Gjorgo** sot më datë 10.07.2020 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me nr.51 UM që i përket :

PADITËS: **Aldi Llapa**, i biri i Agim, i datëlindjes 31.03.1991, lindur dhe banues në Pirg, Nj. Adm. Pirg, Bashkia Maliq, me shtetësi shqiptare, në mungesë.

I PADITUR: **Agim Llapa**, i biri i Haxhi dhe Fitret, i datëlindjes 25.05.1960, lindur dhe banues lindur dhe banues në Pirg, Nj. Adm. Pirg, Bashkia Maliq, me shtetësi shqiptare, identifikuar me pasaportën BF4884673 me numër personal G00525123G, përfaqësuar vetë në gjykim.

OBJEKTI: Vërtetim i urdhërët të menjëhershëm të mbrojtjes.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar

Gjykata pasi çeli seancën gjyqësore të verifikimit të urdhërët të menjëhershëm të mbrojtjes ku rezultoi se nuk ishte paraqitur paditësi dhe ishte paraqitur i padituri,

VËREN:

Paditësi Aldi Llapa i është drejtuar gjykatës, me kërkesëpadinë me objekt dhe palë si më sipër.

Rezulton se paditësi Aldi Llapa i është drejtuar Komisariatit të Policisë Maliq, ku ka deklaruar se: “*Jam me banim në adresën e mësipërme ku banoj me bashkëjetuesen time Redina Mallelli. Sot rreth orës 16:00 babai im shtetasi Agim Llapa i cili ishte në gjendje të dehur erdhi tek dera e shtëpisë time dhe më tha: “hiqe portën se do e prish me forcë”. Për këtë arsyeshajtua politici pasi ndihesha i kërcënuar si dhe për vetën edhe bashkëjetuesen time. Menjëherë erdhi policia dhe iu tregova në lidhje me konfliktin që pata më babain. U shoqëruam në ambientet e Komisariatit të Policisë Korçë dhe për shkak të situatës së pandemisë kërkova*

urdhër mbrojtje pasi ndihem i frikësuar. Për shkak të gjendjes time të rënduar i kërkova punonjësit të policisë të mbante këtë deklaratë me thëniet e mia.”

I padituri, i pyetur në Komisariatin e Policisë Maliq, ka deklaruar se: “*Jam me banim në adresën e mësipërme ku banjo me gruan dhe djalin tim të vogël. Sot rreth orës 16:00 unë pata 1 (një) debat me djalin tim shtetasin Aldi Llapa për arsyen se ai kishte hapur një derë tek toka ime, pa lejen time ose të mamasë. Prona është e gruas dhe kërkoi nga ai që të më japër lekët dhe ta gjëzojë. Kërkoi që nga ana juaj t'i jepet një zgjidhje problemit. Për sa më sipër janë fjalët e mia të cilat i them me vullnetin tim të lirë. Për arsyen se jam në gjendje të dehur këtë deklaratë i thashë të ma mbante punonjësi i policisë.*”

Ndërkohë në raportin “Për vlerësimin e riskut për rastin e dhunës në familje” të Komisariatit të Policisë Maliq, është pasqyruar se paditësi ka deklaruar se: “*Më datë 03.05.2020, unë ndodhesha në banesën time së bashku me bashkëjetuesen time Redina Malelli dhe në atë kohë vjen në gjendje të dehur në shtëpinë tonë babai im Agim Llapa i cili më thotë “do ta heqësh derën, ose do vi dhe do ta prish. Po nuk e hoqe derën do vi natën dhe do ta prish dhe do të t'vras”.*

Për këtë arsyen paditësi Aldi Llapa ka përpiluar kërkësepardinë objekt gjykimi, duke kërkuar marrjen e masës që i padituri Agim Llapa të mos i afrohet, të mos e cënojë, ngacmojë apo kontaktojë, të mos e kërcënojë, të mos i shkojë në strehë, vendin e punës dhe të mos kryejë ndaj saj vepër të dhunës në familje etj.

Kjo kërkësepadi është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nga Komisariati i Policisë Maliq, me shkresën përcjellëse Nr.2216 prot datë 04.05.2020, regjistruar në gjykatë më datë 04.05.2020, ora 10:40.

Gjykata në zbatim të nenit 18/1/b, të ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat e dhunës në marrëdhëni familiare”, i ndryshuar, (në vijim ligjit 9669/2006), caktoi seancën gjyqësore për zhvillimin e gjykimit më datë 06.05.2020, ora 09:30 dhe njoftoi palët.

Në seancën e datës 06.05.2020, ora 09:30, nuk u paraqit paditësi dhe u paraqit padituri. Me vendimin e datës 06.05.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi:

“1. Lëshimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes për paditësit Aldi Llapa duke marrë këto masa:

I padituri Agim Llapa të mos i afrohet paditësit Aldi Llapa përgjegj një distance prej 100 metra.

I padituri Agim Llapa të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj paditësit ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së paditësit Aldi Llapa.

I padituri Agim Llapa të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësin Aldi Llapa ose pjesëtarë të familjes së paditësit;

I padituri Agim Llapa ndalohet menjëherë që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga paditësi Aldi Llapa, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsyen pune.

1. Ky urdhër lëshohet përnjë afat 20 ditor dhe palët do të paraqiten para gjykatës përvërtetimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes, më datë 26.05.2020, ora 11:00.

2. Shkelja e vendimit të gjykatës përlëshimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të K.Penal:

3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Që renditet, më diel 18.05.2020, në 13:14, të i dërgohet mësuesi i gjykatës së përgjegjshme.

Që renditet, më diel 18.05.2020, Gjyqtari i gjykatës së përgjegjshme Korçë, vendosur:

“I lëshohet i urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv.”

Faqe nr.2

4. Paditësi do të pajiset me dy kopje vendimi, në mënyrë që njëren ta mbajë vetë dhe tjetrën t’ia vejë në dispozicion policisë, në momentin që paraqitet nevoja.
5. I Padituri do të pajiset me një kopje të vendimit.
6. Një kopje e këtij vendimi, t’i dërgohet për zbatim Komisariatit të Policisë Maliq, Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Maliq dhe Zyrës së Përmbarimit Korçë.”

Ky vendim iu komunikua palëve si dhe të gjithë institucioneve që merren me ekzekutimin e vendimeve të Urdhrale të Menjëhershëm të Mbrojtjes brenda afatit prej 24 orëve të parashikuar në nenin 19/5 të Ligjit Nr.9669 datë 18.10.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare”, Komisariatit të Policisë Maliq dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Bashkia Maliq, institucione të cilat edhe pse në dijeni të seancës për “Vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”, nuk paraqiten në gjykim asnjë informacion lidhur me këtë çështje.

Në seancën e datës 26.05.2020, u paraqit i padituri ndërsa paditësi nuk u paraqit në seancë dhe nga komunikimi telefonik në numrin e përcaktuar në kërkesëpadi, bëri me dije se nuk kishte dijeni për datën dhe orën e seancës gjyqësore pasi nuk e kishte lexuar vendimin për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe nuk mund të paraqitej për arsyen shëndetësore. Gjykata në këto rrethana shtyu seancën për më datë 09.06.2020, ora 11:00, seancë në të cilën u paraqit i padituri dhe nuk u paraqit paditësi, i cili kishte dijeni përmes njofimit përmes telefonit, ndërsa letërthirja e komunikuar përmes shërbimit postar nuk rezultoi të ishte kthyer mbrapsht deri në ato momente. Nga komunikimi telefonik i bërë para fillimit të seancës gjyqësore, më datë 09.06.2020, paditësi deklaroi se nuk është paraqitur për shkak të mungesës së shërbimit të transportit publik. Në këto rrethana gjykata vendosi të shtyjë seancën për më datë 25.06.2020, ora 13:00, duke rinjofuar paditësin.

Në seancën e datës 25.06.2020, nuk rezultoi të ishte i pranishëm paditësi për të cilin nuk konfirmohej marrja dijeni, pasi nuk rezultoi të ishte kthyer deri në atë moment letërthirja komunikuar përmes shërbimit postar dhe gjithashtu nuk rezultoi prezent as i padituri. Gjykata vendosi të shtyjë seancën për më datë 10.07.2020, ora 13:00. Në këtë seancë rezultoi i pranishëm i padituri Agim Llapa, ndërsa për paditësin rezultoi të ishte kthyer letërthirja komunikuar përmes shërbimit postar rezultoi e kthyer me shënimin “Personi ndodhet në Vlorë në punë. Bisedova me të shoqen dhe ajo më tha se ndodhet në Vlorë dhe nuk vjen dot.”. Ndërkohë përmes komunikimit telefonik, rezultoi se numri i telefonit të paditësit ishte i padisponueshëm.

2. Vlerësimi i gjykatës.

Neni 179 i K.Pr.Civile në të cilin parashikohet se: “1. Nëse asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit. 2. Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit. 3. Nëse i padituri, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, nëse paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë. 4. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, gjykata nuk njofton më palën që vendos të gjykojë në mungesë.”.

Neni 299/ç i K.Pr.Civile në të cilin parashikohet se: "Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ... ç) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj. ".

Neni 301 i K.Pr.Civile në të cilin parashikohet se: "Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi, pushimi ose refuzimi i rifillimit të gjykimit, mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj."

Në nenin 13 të ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, me titull "Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëherëshëm të mbrojtjes" të titulluar "Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes", parashikohet se:

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktima;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia / prokuroria.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

- a) prindi ose kujdestari i të miturit;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) të afërmít;

ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktima, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimate të dhunës në familje, të njoitura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

dh) policia/prokuroria;

e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.

3. Kërkesën për urdhër të menjëherëshëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktima;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia/prokuroria;

ç) personi me të cilin viktima ka marrëdhënien familjare;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktima, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

dh) qendrat, dhe shërbimet përmbrnjteje dhe rehabilitimin e viktimate të dhunës në familje, të njoitura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje,

4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar."

Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën, përveç kur ligji parashikon ndryshe (neni 2 i K.Pr.Civile). Parimi i iniciativës së palëve u njeh të drejtën palëve për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të disponuarinë lidhje me padinë/kërkësën, në mënyrë individuale. Kodi i Procedurës Civile rregullon mosparaqitjen e palëve në seancë, përgatitore ose gjyqësore në nenin 179 të tij. Konkrektisht, në paragrafin e parë të këtij neni rregullohet rasti i mosparaqitjes së asnjëra viktima nga palët në gjykim, paditësit dhe të paditurit. Në këtë rast gjykata nëse vlerëson se nuk ka një shkak të arsyeshëm përmungesën e tyre, vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

Ndërsa në rastin e paragraftit të dytë të nenit 179, rregullohet rasti kur nuk paraqitet paditësi pa ndonjë shkak të arsyeshëm, dhe ndërkohe i padituri, nuk e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes deri në atë moment, ku në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit. Ndërsa në rastin kur paditësi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, por ndërkohe i padituri

e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes në gjykatë, ky i fundit mund të kërkojë që të vazhdojë gjykimi dhe në mungesë të paditësit, nësë nga gjykata vlerësohet se i padituri ka një shkak të ligjshëm për vazhdimin e gjykimit. Ndërkohë, në paragrafin e tretë, në rastin e mosparaqitjes së të paditurit pa ndonjë shkak të arsyeshëm, gjykata mund të vazhdojë gjykimin vetëm nësë paditësi kërkon që gjykimi të vazhdojë në mungesë të të paditurit.

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me gjykimin e një kërkesëpadie civile të bazuar në ligjin e posaçëm Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, gjykata do analizojë prezencën e paditësit ne seancë në raport me vazhdimin e gjykimit.

Kështu, sipas nenit 179 të K.Pr.Civile, gjykata vendos pushimin e gjykimit për mosparaqitjen e paditësit/kërkuesit kur plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte të domosdoshme, konkretisht:

Së pari: Pasja dijeni e palës paditëse/kërkuese për datën dhe orën e zhvillimit të seancës përgatitore ose gjyqësore.

Së dyti: mosparaqitja e palës në seancën e caktuar, pa ndonjë shkak të arsyeshëm për të cilën gjykata duhet të vihet në dijeni paraprakisht.

Rezultoi se seancën gjyqësore të planifikuar për tu zhvilluar në datë 10.07.2020 ora 13:00, nuk u paraqitën e paditësi Aldi Llapa, i cili kishte dijeni irregullisht për datën dhe orën e seancës gjyqësor me letëthirrjen e datës 10.07.2020, ora 13:00 përmes bashkëshortes së tij, e cila ka deklaruar se paditësi nuk paraqitet dot pasi ndodhet me punë në Vlorë. Gjykata duke marrë parasysh faktin se rezulton se paditësi është njoftuar tek bashkëshortja e tij, ka marrë dijeni për datën dhe orën e seancës dhe nuk ka paraqitur vetë ndonjë shkak të justifikuar për mospraninë në këtë seancë, duke marrë parasysh se për seancat e shtyra me qëllim njoftimin e të paditësit, ka marrë dijeni për disa nga seancat e kaluara dhe për seancën e datës 25.06.2020, por letërthirrja është kthyer më vonësë në gjykatë nga shërbimi postar, vlerëson se paditësi nuk ka treguar interes për tu paraqitur në çështjen e iniciuar prej tij me objekt gjykimi verifikimin e lëshimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 179/2 si dhe nenin 299/c të K.Pr.Civile dhe nenit 13/4 të ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, gjykata çmon se në rastin konkret duhet të vendosë pushimin e gjykimit për shkak të mosprezencës në gjykim së paditësit, pa ndonjë shkak të përligjur.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 179/2, 299/c, 300 dhe 301 të K.Pr.C. dhe nenit 13/4 të ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes civile me palë paditëse Aldi Llapa dhe të paditur Agim Llapa, me objekt lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankrim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot më 10.07.2020.

SEKRETARE
ADELA GJORGO



GJYQTAR
ERVIN SULAJ

